



NJOFTIM

Në mbështetje të ligjit nr. 140/2020 “Për censin e popullsisë dhe banesave” dhe ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, nenit 801 e vijues të Ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, INSTAT kërkon oferta për ambjentet e punës dhe magazinimit në të gjitha bashkitë e vendit.

Ambjentet që do të merren me qira duhet të plotësojnë secifikimet teknike dhe afatet përkatëse për secilën bashki, të cilat gjenden në kartelat bashkëngjitur këtij njoftimi.

Përveç specifikimeve teknike, ofruesi i ambjentit/eve duhet të marrë parasysht plotësimin e këtyre kushteve:

1 - Oferta për dhënien me qira të ambjentit duhet të jetë e shoqëruar me dokumentet e mëposhtme të njësuara me origjinalin:

i. çertifikatën e pronësisë dhe planimetrinë e ambjentit të ofruar;

ii. kopjen e dokumentit të identifikimit të pronarit të objektit (pasaportë ose kartë identiteti)

iii. kopjen e librezës së energjisë elektrike dhe ujit, ku vërtetohet se objekti nuk figuron debitor në furnizimin me energji elektrike dhe ujë;

2 – Oferta duhet të jetë sipas formatit nr. 1 “Ofertë” bashkëngjitur këtij njoftimi;

3 – Për marrjen me qira të ambjentit, INSTAT do të nënshkruajë kontratën përkatëse në përputhje me dispozitat e Kodit Civil për marrjen e sendeve me qira dhe duke marrë parasysht këto kushte:

i. Vlera mujore e qirasë do të përfshijë edhe detyrimet tatimore të parashikuara në legjislacionin në fuqi;

ii. Pagesa do të kryhet nga INSTAT-i brenda 10 ditëve të muajit pasardhës, në llogarinë bankare të deklaruar nga ofertuesi;

iii. Objekti i marrë me qira duhet të vihet në dispozicion nga ofertuesi brenda 10 ditëve nga njoftimi për lidhjen e kontratës.

4. Ofertat sipas kritereve të përcaktuara në këtë njoftim, duhet të paraqiten në zarf të mbyllur jo më vonë se data 30 Qershor 2023, ora 10.00 në adresat përkatëse të Zyrave Rajonale të Statistikave në nivel qarku:



Qarku Tiranë

Adresa: Instituti i Statistikave, Rr. Vllazen Huta, Nd. 35, H.1, Njësia Administrative nr. 2, 1017, Tiranë

Qarku Durrës

Adresa: Zyra Rajonale Statistikore Durrës, Godina e Këshillit të Qarkut, Lagja 2, Sheshi “Liria”; Kati 4, Durrës

Qarku Korçë

Adresa: Zyra Rajonale Statistikore Korçë, Lagja nr. 7, Rr. 28 Nëntori, Godina e ish-Bashkisë Korçë, Kati I.

Qarku Elbasan

Adresa: Zyra rajonale e statistikave, L. “Brigada 17-të sulmuese”, Rr. 11 Nëntori, Godina e Prefekturës Elbasan, kt. 3

Qarku Fier

Adresa: Zyra Rajonale Statistikore Fier, Lagja “Kastriot”, Rruga Ramiz Aranitasi, Godina e Bashkisë Fier, Hyrja Qarku, kt. 3

Qarku Berat

Adresa: Zyra Rajonale Statistikore Berat, Blv. “Republika”, pranë godinës së Këshillit të Qarkut Berat, kt. 2

Qarku Gjirokastrë

Adresa: Zyra Rajonale Statistikore Gjirokastrë, Godina e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë, Rr. Ismail Kadare, kt. 3

Qarku Vlorë

Adresa: Zyra Rajonale Statistikore Vlorë, Sheshi “4 Heronjtë”, Lagja 15 tetori, Vlorë

Qarku Lezhë

Adresa: Zyra Rajonale Statistikore Lezhë, Lagja Besëlidhja, rr. Gjergj Fishta, Nd. 3, hyrja 8, ap. 5, kt 3

Qarku Shkodër



Adresa: Zyra Rajonale Statistikore Shkodër, Bulevardi Skënderbeu, Godina Albtelekom, kt.2

Qarku Dibër

Adresa: Zyra Rajonale Statistikore Dibër, Blv Elez Isufi, ish-Godina e Kom.Partisë, kt. 4, Peshkopi

Qarku Kukës

Adresa: Zyra Rajonale Statistikore Kukës, Sheshi Skënderbe, Lagja 5, Pll. 10, Kati 1/5, pranë gjykatës, Kukës.”